



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr 65, datë 22/12/2004

**“PËR SHPËRBLIMIN E DISA PUNONJËSVE TË BASHKISË
PËR VITIN 2004”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit Nr.7776, dt.22/12/1993 “Për buxhetin lokal”, ndryshuar me ligjin Nr.8399, dt.09/09/1998, ligjit Nr.8549, dt.11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.16, dt.10/03/2004 “Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2003 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2004”, me rastin e festave të fundvitit, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë shpërblimin me një pagë mujore të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit.
2. Të miratojë shpërblimin me një pagë mujore të punonjësve të Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit.
3. Të miratojë shpërblimin me 3 paga mujore për 12 punonjës të Policisë Bashkiake (1 Kryeinspektor, 8 Inspektorë dhe 3 Policë)
4. Efektet financiare për zbatimin e pikës 1 dhe 2 të këtij Vendimi në shumën prej 12.500.000 lekësh të përballohen nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës duke pakësuar Fondin Rezervë për vitin 2004 dhe duke shtuar në buxhetin e:
 - **Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit** shumën prej 9.000.000 lekësh në artikullin 600 “Paga”
 - **Drejtorisë Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit** shumën prej 3.500.000 lekësh në artikullin 600 “Paga”
5. Efektet financiare të pikës 3 të këtij Vendimi të përballohen brenda fondit të pagave të Aparatit të Bashkisë të miratuar në buxhetin e vitit 2004.
6. Administrata e Bashkisë shpërblehet në bazë të ligjit Nr.8549, dt.11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil”.
7. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtorja e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore.
8. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI